



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,
NR.6
TEL: 693645101

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)


Nr. repertori: 355

Nr. koleksioni: 79

Tirane më 11/01/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



A2024051400005913989

*Akti notarial përbëhet nga 6 fletë





A2024051400005913989

**KONTRATË DHURIMI E KALIMIT TË
KUOTAVE TE SHOQERISE**

**ZYRA LIGJORE "RAKIPI &
PARTNERS" shpk**

Sot, më datë 11/01/2024, para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6, u paraqit personalisht:

Znj. Vilma Rakipi, atësia Rexhep, amësia Beniamin, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Ymer Kurti; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 02/09/1966, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033823006 dhe nr. personal G60902134S, disponuese e 55.00 % të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Rakipi & Partners" shpk regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M01908027N, me seli në adresë Rruga Ibrahim Rugova, Pallatet Green Park Tower, Kulla Nr.1, Kati Nr.11, Ap Nr.54.

(në vijim Dhuruesi i kuotes prej 55% te Shoqerise Zyra Ligjore "Rakipi & Partners")

Dhe

Z. Jon Rakipi, atësia Arben, amësia Vilma, shtetas Holandez, lindur në Tirane dhe banues në Hollande, lindur më 08/07/1993, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pashaporten me Nr. NM7B1BBL5.

(në vijim Pranuesi i Dhurimit te kuotes prej 55% te Shoqerise Zyra Ligjore "Rakipi & Partners")

Dhuruesi dhe Pranuesi jane referuar me poshte individualisht si "Pala" dhe se bashku si "Palet".

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

MEQENESE:

- A. Dhuruesi zotëron 55.00 % te kuotave te Kapitalit te Shoqërisë "Rakipi & Partners" sh.p.k, një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe qe funksionon sipas legjislacionit tregtar shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit me NUIS-NIPT M01908027N, me seli kryesore ne adresen: Rruga "Ibrahim Rugova", Pallatet Green Park, Kll.2 Kt.11 Ap.54. Tirane;
- B. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lek (njëqind lek), i ndare midis Ortakeve te Shoqerise ne kete menyre:



Znj. Vilma Rakipi është zoteruese e 55.00 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Jon Rakipi është zoterues i 10.00 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Ermir Beta është zoterues i 20.00 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Znj. Romina Lleshi (Zano) është zotëruese e 15.00 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Me anë të kësaj kontrate Dhuruesi i transferon Pranuesit të Dhurimit me anë të dhurimit, pa kurrfarë detyrimi financiar apo shpërblimi, natyror apo obligim juridik, 55.00 % të kapitalit të Shoqërisë Zyra Ligjore **“Rakipi & Partners” sh.p.k** që kanë një vlerë nominale prej 55 lekësh;

C. Pranuesi i Dhurimit shpreh dakordësinë që të pranojë 55.00 % të Kapitalit të Shoqërisë së lartpërmendur Zyra Ligjore **“Rakipi & Partners” sh.p.k;**

D. Në përputhje me Nenet e Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit shqiptar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Nr. 9901, datë 14.04.2008 me ndryshet perkatese, Asambleja e Ortakeve të shoqërisë ka marrë vendimin perkates, për transferimin tek Pranuesi i dhurimit të kuotave si më sipër.

E. Në bazë të Statutit të Shoqërisë (“**Statuti**”) kuotat mund të transferohen lirisht mes ortakeve/apo të tretëve dhe asnjëri prej ortakeve të Shoqërisë nuk ka ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë.

F. Palet bien dakord për nënshkrimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave nëpërmjet Dhuruesit dhe Pranuesit të Dhurimit (“**Kontrata tjetërsimin e kuotave nëpërmjet Dhurimit**” ose “**Kontrata**”), si më poshtë vijon:

NENI 1 **Perkufizime**

1.1 Përveç shprehjeve të tjera të perkufizuara ndryshe në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, fjalet dhe shprehjet që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtem:

“**Kontrate**” do të thotë kjo Kontratë për Tjetërsimin e Kuotave nëpërmjet **Dhurimit**— duke përfshirë si pjesë perberëse të saj, deklaratat paraprake të mesiperme;



A2024051400005913989


- “Shoqeria”* Shoqeria **“Rakipi & Partners” Sh.p.k.**, është një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, me NIPPT M01908027N, me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Green Park Tower, Kll.2, Kt.11 Ap.54;
- “Barre”* do të thotë cdo hipoteke, detyrim, peng, garanci, e drejte zgjedhjeje, kufizim, e drejta e parablerjes, e drejta ose interesi i një pale të tretë, barre ose interesa siguruese të cdo lloji, ose cdo lloj tjetër marreveshjeje preferenciale (duke përfshirë por pa u kufizuar në transferimin e një titulli ose të një marreveshjeje kontrolluese) me efekte të ngjashme;
- “Pala” ose “Palet”* do të thotë Dhuruesi ose Pranuesi i Dhurimit ose të dy së bashku, sic e kërkon përmbajtja;
- “Kuota në tjetërsim”* do të thotë e barabarta me 55.00% (pesëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, që kanë një vlerë nominale prej 55 lekësh.

NENI 2 Objekti i Kontrates

- 2.1** Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate (**“Data e Nënshkrimit”**), Dhuruesi i transferon Pranuesit të Dhurimit, dhe Pranuesi i Dhurimit pranon të transferohen tek ai dhe 55.00% të kuotave të shoqërisë të lira nga cdo Barre.
- 2.2** Me pranimin e kuotave të dhuruara nga pala dhuruese (55% të kuotave që zotërohen nga pala dhuruese që kanë një vlerë nominale prej 55 lekësh), pranuesi i dhurimit Jon Rakipi i cili zotëron aktualisht 10% të kuotave të Shoqërisë, behet përfundimisht zotëruar i 65 % të kuotave të Shoqërisë **“Rakipi & Partners”** shpk që kanë një vlerë nominale prej 65 lekësh.
- 2.3** Kuota në Dhurim do të transferohet juridikisht nga pronësia e Dhuruesit në pronësi të Pranuesit të Dhurimit dhe pala pranuese do të behet zotëruar ligjor i kuotes në momentin e menjëhershëm të nënshkrimit të kësaj Kontrate Dhurimi, pas regjistrimit të kësaj kontrate pranë QKB-se.

NENI 3 Deklarimet dhe Garancitë e Dhuruesit

- 3.1** Dhuruesi deklaron dhe garanton në lidhje me dhurimin e kuotave që parashikohet në këtë Kontratë, për të gjitha çështjet që vijojnë.
- 3.1.2** *Nënshkrimi* – Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk kërkon asnjë depozitim, miratim, autorizim të çfaredolloji nga ndonjë autoritet shtetëror ose pale e tretë.
- 3.1.3** *Pronësia* – Dhuruesi është pronari i vetëm dhe i ligjshëm i Kuotes në dhurim. Kuota është përcaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe janë shlyer plotësisht nepermjet kontributit në para në kapitalin themeltar të Shoqërisë.



A2024051400005913989

- 3.1.4** *Kuotat* - Kuotat janë të lira dhe të ciluara nga çdo Barre e çfaredo lloji dhe Dhuruesi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i Dhuruar, për t'i kaluar, transferuar dhe dorëzuar Kuotat në përputhje me afatet e kësaj Kontrate. Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë Barre në lidhje me Kuotat ose ndonjë numer Kuotash të autorizuar por të paemtuara në kapitalin e Shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë të drejtë mbi ndonjë Barre lidhur me ndonjë nga Kuotat. Përveç kësaj Kontrate, nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që parashikon dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin ose dhenien e se drejtës një personi, të drejtën e parablerjes apo të kembimit, në lidhje me Kuotat objekt të kësaj kontrate.
- 3.1.5** Mbi pranuesin e dhurimit nuk rëndon asnjë detyrim i lindur mbi kuotat që zotëron Dhuruesi deri në momentin e kalimit të pronësisë të saj.
- 3.1.6** **Pranuesi i dhurimit dhe dhuruesi bien dakord që dividenti i përfituar për vitin financiar 1 Janar 2023-31 Dhjetor 2023, do t'i mbetet dhuruesit të kuotave znj. Vilma Rakipi.**

Neni 4

Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni kompetent

- 4.1** Kjo Kontratë rregullohet nga ligji Shqiptar.
- 4.2** Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.3** Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, pala tjetër i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 5

Te ndryshme

- 5.1** Cdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim, dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës Pale.
- 6.2** Në rast se një dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të preket nga një fakt i tillë.
- 6.3** Palet do të përpiqen të zëvendësojnë një dispozitë të pazbatueshme ose të pavlefshme, në masën me të madhe të mundshme, për të arritur qelimin e kësaj dispozite.
- 6.4** Kjo Kontratë nënshkruhet në tre (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.



A2024051400005913989

6.5 Asnjera Pale nuk mund te kaloje dhe / ose te transferoje te drejtat dhe / ose detyrimet sipas kesaj Kontrate, ne teresi ose ne vecanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Pales tjetere.

Kontrata, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Bashkëlidhur gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DHURUESI

PRANUESI I DHURIMIT

ZNJ. VILMA RAKIPI

Z.JON RAKIPI

Vilma Rakipi
[Signature]

Jon Rakipi
[Signature]

NOTER

ALKET Z.MANÇKA

[Signature]
[Signature]